



Buletin informativ

Mars 2022



Ekspertët fiskal në Mazars, sjellin pranë jush buletin informativ të rradhës si një përmbledhje e ndryshimeve ligjore të publikuara në vendin tonë.

❖ **Ndryshon paga minimale në shkallë vendi**

Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, bëhet 32,000 lekë. Paga minimale aktualisht është 30 000 lekë.

Në të njëjtën masë indeksohet dhe paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore. Kështu ajo rritet nga 132,312 Lekë në 141,133 Lekë.

Vendimi i ndryshimit të pagës minimale në shkallë vendi shtrin efektet financiare që nga data 1 prill 2022.

Burimi: Fletore Zyrtare nr. 40, datë 14.03.2022, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 12.3.2022, Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi

❖ **Ndryshon afati për zbatimin e skemës së re të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP)**

Skema e re e përlllogaritjes së TAP do të shtrij efektet financiare që nga data 1 prill 2022. Fillimisht u përcaktua se ky ndryshim do të hynte në fuqi më 1 korrik 2022.

Buletin informativ

Për rikujtesë, më poshtë gjeni skemën e re të përlogaritjes së TAP:

E ardhura nga paga (Lekë/muaj)		E ardhura e tatueshme (Lekë/muaj)		Norma tatimore (%)
Nga:	deri në (duke përfshirë):	Nga:	deri në (duke përfshirë):	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50% * 13% të shumës mbi 30,000 Lekë
50,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% të shumës mbi 30,000 Lekë
		200,001	Më tepër	22,100 lekë + 23% të shumës mbi 200,000 Lekë

Burimi: Fletore Zyrtare nr. 40, datë 14.03.2022, Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 12.3.2022, Për një ndryshim në ligjin nr.113/2021, "Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar

❖ Përfshihen në skemën e TVSH-së noterët dhe përmbauesit gjyqësor

Noterët dhe përmbauesit gjyqësor shtetëror dhe privat do të duhet të regjistrohen në skemën e TVSH-së, pavarësisht qarkullimit vjetor të tyre. Kështu, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në për këta tatimpagues do të jetë zero. Gjithashtu, ata do të duhet të jenë të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuara sipas ligjit.

Efektet e këtij ndryshimi hyjnë në fuqi në datë 8 mars 2022, menjëhere me botimin në fletore zyrtare.

Burimi: Fletore Zyrtare nr. 35, datë 08.03.2022, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 2.3.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, 'për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë', të ndryshuar

❖ Ndryshime në ligjin nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar

Duke parë numrin e ulët të personave juridik të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), të cilët kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin e pronarëve përfitues sipas kërkesave të ligjit 112/2020 "Për regjistrimin e pronarëve përfitues" të ndryshuar, është miratuar nga Këshilli i Ministrave një vendim që përmban parashikimet e mëposhtme:

Falen gjobat në lidhje me parashikimet e ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar

Gjobat e vendosura përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi (02.03.2022) për mospërmbushjen në kohë të detyrimeve ligjore të lidhura me regjistrimin fillestar, si dhe me

Buletin informativ

ndryshimet e të dhënave të regjistruara të pronarëve përfitues, të cilat nuk janë paguar, falen në masën 100%.

Ndërkohë që, subjektet raportuese, të cilat kanë paguar gjobat që falen sipas parashikimeve të mësipërme dhe kanë përmbushur detyrimet përkatëse për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues, kanë të drejtë të aplikojnë pranë QKB-së për rimbursimin e shumave të paguara.

Ndryshojnë afatet dhe gjobat për regjistrimin e pronarëve përfitues (RPP)

Për të gjitha subjektet me **pronësi direkte**, regjistrimi i pronarëve përfitues në RPP do të bëhet nga QKB në mënyrë automatike duke marrë të dhënat e nevojshme nga regjistri tregtar. Për subjektet e regjistruara para bërjes efektive të këtyre ndryshimeve, të dhënat e pronarëve përfitues do të plotësohen brenda datës 30 qershor 2022. Ndërkohë, për subjektet e regjistruara pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, të dhënat për pronarët përfitues do të plotësohen menjëherë pas regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar.

Nga ana tjetër, për subjektet e tjera gjeni më poshtë tabelën përmbledhëse lidhur me afatet dhe gjobat për mosregjistrimin fillestar të pronarëve përfitues:

	Afati / Gjoba		
	0 – 40 ditë	41 – 80 ditë	Mbi 81 ditë
Regjistrim fillestar i pronarëve përfitues			
<i>Subjektet me pronësi indirekte</i>	-	50 000 ALL	600 000 ALL
<i>Organizat Jofitimprurëse</i>	-	50 000 ALL	600 000 ALL

Për më tepër, lidhur me ndryshimet e të dhënave të pronarëve përfitues, afati i regjistrimit dhe gjobat për mosregjistrimin brenda afatit do të aplikohen si më poshtë:

	Afati / Gjoba	
	0 – 90 ditë	Mbi 91 ditë
Ndryshim i të dhënave të pronarëve përfitues	-	400 000 ALL

Ndërkohë, është hequr dënimi me gjobë prej 150 000 lekë për përfaqësuesin ligjor të subjektit në rast të mosregjistrimit të të dhënave për pronarin përfitues.

Burimi: Fletore Zyrtare nr. 25, datë 15.02.2022, Ligj nr. 6/2022, datë 27.1.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar.

❖ Ndryshimi i gjobave për regjistrimin e biznesit

Rriten gjobat nga 15 000 lekë në 60 000 lekë, për deklaratimet e të dhënave të pavërteta në regjistrin e biznesit. Gjithashtu, e njëjta rritje është bërë për të gjitha gjobat që lidhen me moskryerjen e regjistrimit fillestar dhe regjistrimeve të tjera të detyrueshme brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Burimi: Fletore Zyrtare nr. 25, datë 15.02.2022, Ligj nr. 7/2022, datë 27.1.2022, Për një ndryshim në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar.



Buletin informativ

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje mbi çështjet e mësipërme ose çështje të tjera në fushën fiskale, ju lutemi kontaktoni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Daniela XHAKO

Head of Accounting and Tax Compliance Services
daniela.xhako@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889

E-mail: info@mazars.al